



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 104/02-6081 2017
Kaçanik, 28.02.2017

Në mbështetje të Vendimit të Kuvendit, 01.Nr.400-2155/1, të datës 27.01.2017 si dhe Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, bënë:

THIRRJE PUBLIKE PËR SUBVENCIONE
Në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vlerë të 36,100 €, për vitin 2017.

KULTURË (Subvencionimet totale në vlerë të 3,000 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha Shoqëritë Kulturore- Artistike të cilat janë të regjistruara në Komunën e Kaçanikut - Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, të cilat janë të dëshmuara për promovimin, ruajtjen dhe kultivimin e vlerave tradicionale, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e tyre vjetor për vitin 2017 dhe në politikat programore të Sektorit për Kulturë.

RINI (Subvencionimet totale në vlerë të 4,800 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha OJQ-të Rinore të cilat janë të regjistruara në Komunën e Kaçanikut - Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, të cilat janë të dëshmuara për promovimin e të drejtave të fëmijëve, promovimin e të drejtave për persona me aftësi të kufizuara, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e tyre vjetor për vitin 2017 dhe në politikat programore të Sektorit për Rini.

SPORT (Subvencionimet totale në vlerë të 28,300 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha Klubet Sportive Publike të cilat janë të regjistruara në Komunën e Kaçanikut - Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, të cilat janë të dëshmuara për promovimin, zhvillimin dhe masovizimin e sportit, gjithnjë duke u bazuar në plan programin e tyre vjetor për vitin 2017 dhe në politikat programore të Sektorit për Sport.

Kërkesa për aplikim për të gjitha sektorët Kulturë, Rini dhe Sport duhet të përmban:

- Qëllimin e kërkesës/projektit;
- Projekt Propozimi bashkë me koston totale dhe kosto që kërkohet nga Komuna;
- Plotësimi i Formularit për aplikim (shkarko aplikacionin <http://kk.rks-gov.net/kacanik>
Kliko : SHPALLJET -----APLIKACIONET ----FORMULARI PËR APLIKIM - KULTURE, RINI, SPORT)

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe dokumentet :

- Certifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Certifikata e numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetimi regjistrimit pranë Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në Kaçanik;
- Vërtetimi i regjistrimit pranë Federatës Përkatëse (vetëm për klubet);
- Letërnjoftimi i personave/aplikantit /që përfaqëson organizatën;
- Xhirollogaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës;
- Dëshmi se nuk ka obligime organizata ndaj ATK;
- Dëshmi për pagesën e taksave komunale.

Data e aplikimit është nga 28.02.2017 deri 14.03.2017.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5 nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.)

Vërejtje:

- *Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nuk do të shqyrtohet;*
- *Konkuruesit të cilët nuk kanë përmyllur avanset e mëparshme ndaj këtij institucioni, nuk do të merren në shqyrtim;*
- *Aplikacionet të cilat dorëzohen jashtë afatit të kërkuar nuk do të shqyrtohen.*

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi

